

V E N D I M
Nr. 531, datë 31.10.2002

**PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË BUTRINTIT DHE TË
TERRITORIT PËRRETH TIJ ZONË NATYRORE VEÇANËRISHT E MBROJTUR DHE
PËRFSHIRJEN E TIJ NË LISTËN E LIGATINAVE ME RËNDËSI
NDËRKOMBËTARE, VEÇANËRISHT SI HABITATE TË SHPENDËVE UJORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 4 të Konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t’u përfshirë në listën e Konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”.

2. Kufijtë e kësaj zone janë:

në veri – Kanali i Cukës, rruga automobilistike që lidh fshatin Cukë me Dritasin dhe Pllakën;

në lindje – vija lidhëse Pllakë-Murrsi, që kalon në malin e Milës;

në jug – Murrsi – kufiri jugor me Greqinë;

në perëndim – nga derdhja e Bistricës (kanali i Cukës) deri në kufirin shtetëror me Greqinë, përfshirë ishujt e Ksamilit dhe të Stillos, duke u futur 1 km në thellësi të detit Jon.

3. Kjo zonë përfshin një sipërfaqe prej 13 500 ha, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi, ku pjesa qendrore është liqeni i Butrintit (1600 ha).

4. Zona, për të siguruar mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm, ndahet në pesë kategori:

- ato të shënuara me “A” përcaktohen si zona qendrore të ruajtjes së biodiversitetit dhe mbrohen në mënyrë strikte (418 ha);

- ato të shënuara me B” përmbledhin tërë territorin e Parkut Kombëtar të Butrintit (PKB) dhe përcaktohen si zona arkeologjike të trashëgimisë kulturore (408 ha);

- ato të shënuara me “C” përcaktohen si zona të burimeve natyrore, ku kryhen veprimtari tradicionale ekonomike dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, (3060) ha;

- ato të shënuara me “D” përcaktohen si zona buferike, pa vendbanime, ku zhvillohen veprimtari tradicionale ekonomike (8 962 ha);

- ato të shënuara me “E” përcaktohen si zona buferike, që përmbledhin vendbanimet urbane, ku zhvillohen veprimtari tradicionale ekonomike (652 ha).

Veprimtaritë ekonomike në territorin e ligatinave lejohen kur janë tradicionale, ruajnë vlerat mjedisore dhe zhvillohen në përputhje me objektivat e planit të menaxhimit të zonës.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, që, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë e të Ushqimit, Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve, me organet e pushtetit vendor dhe me organizatat jofitimprurëse, të hartojë planin e menaxhimit të zonës.

6. Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe e Koordinimit e qytetit antik të Butrintit, Sarandë, nën juridiksionin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe të Kullotave dhe Drejtorinë e Peshkimit, të realizojë menaxhimin e zonës dhe të kontrollojë zbatimin e planit menaxhues, në përputhje me ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

